**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

---

# PROJEKTLIGJI PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS[1]

# DRAFT LAW FOR THE ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS OF KOSOVA[2]

# NACRT ZAKONA O AKADEMIJI NAUKA I UMETNOSTI KOSOVA[3]

---

[1] Projektligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 25-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 03/25, datë 29.04.2015.
[2] Draft Law for the Academy of Sciences and Arts of Kosova, was approved on 25 meeting of the Government of the Republic of Kosovo with the decision No.03/25 date 29.04.2015.
[3] Nacrt Zakona o Akademiji Nauka i Umetnosti Kosova, osvojen je na 25 sednice Vlade Republike Kosova, odluku Br.03/25, datum 29.04.2015.

| | | |
|---|---|---|
| Kuvendi i Republikës së Kosovës,<br>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | The Assembly of the Republic of Kosova,<br>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosova, | Skupština Republike Kosova,<br>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova, |
| Miraton: | Approves: | Usvaja: |
| **LIGJ PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS** | **LAW FOR THE ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS OF KOSOVA** | **ZAKON O AKADEMIJI NAUKA I UMETNOSTI KOSOVA** |
| **KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi i ligjit** | **Article 1**<br>**The purpose** | **Član 1**<br>**Cilj zakona** |
| 1. Qëllimi i ligjit është: | 1. The purpose of law is: | 1. Cilj zakona je : |
| 1.1. Përkufizimi i funksionit të përgjithshëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë Akademia); | 1.1. Definition of the general function of the Academy of Sciences and Arts of Kosova (in further text, Academy); | 1.1. Definisanje ukupne funkcije Akademije nauka i umetnosti Kosova (u daljem tekstu Akademija); |
| 1.2. Organizimi i Akademisë, dhe | 1.2. Organization of the Academy, and | 1.2. Organizovanje Akademije, i |
| 1.3. Aspekte të tjera të funksionimit të Akademisë. | 1.3. Other aspects of the Academy function | 1.3. Drugi aspekti funksionisanja Akademije. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Themelimi dhe statusi** | **Article 2**<br>**The establishment and status** | **Član 2**<br>**Osnivanje i status** |
| 1. Akademia është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit në Republikën e Kosovës, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. | 1. The Academy is the highest institution of science and arts in the Republic of Kosova, established by the Assembly of the Republic of Kosova. | 1. Akademija je najviša institucija nauke i umetnosti u Republici Kosova, osnovana od strane Skupštine Republike Kosova. |
| 2. Republika e Kosovës siguron kushte për punë dhe zhvillim të Akademisë. | 2. The Republic of Kosova provides work conditions and development of the Academy. | 2. Republika Kosova osigurava uslove za rad i razvoj Akademije. |
| 3. Akademia është institucion i mëvetësishëm në fushën e shkencës dhe të artit. | 3. The Academy is an independent institution in the field of science and art. | 3. Akademija je samostalna institucija u oblasti nauke i umetnosti. |
| **Neni 3**<br>**Veprimtaria e Akademisë** | **Article 3**<br>**The activity of the Academy** | **Član 3**<br>**Delatnost Akademije** |
| 1. Veprimtaria e Akademisë është veprimtari e interesit të veçantë publik në Republikën e Kosovës. | 1. The activity of the Academy is activity of special public interest in the Republic of Kosova. | 1. Delatnost Akademije je delatnost od posebnog javnog interesa u Republici Kosova. |
| 2. Interesi i veçantë publik i Akademisë shprehet në ushtrimin e veprimtarisë së saj në fushën e shkencës dhe të artit, që përfshin promovimin, kultivimin, nxitjen dhe zhvillimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike. | 2. The special public interest of the Academy is expressed in exercising its activity in the field of science and of art, which includes promotion, cultivation, simulation and development of scientific opinion and of artistic creativity. | 2. Posebni javni interes Akademije se odražava u vršenju njene delatnosti u oblasti nauke i umetnosti, koja uključuje promociju, negovanje, unapredjivanje i razvoj naučne misli i umetničkog stvaralaštva. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 4**<br>**Selia dhe emblema e Akademisë**<br>1. Selia e Akademisë është në Prishtinë.<br>2. Akademia ka emblemën e vet. | **Article 4**<br>**The residency and emblem of the Academy**<br>1. The residency of the Academy is in Prishtina.<br>2. The Academy has its own emblem. | **Član 4**<br>**Sedište i emblema Akademije**<br>1. Sedište Akademije je u Prishtini.<br>2. Akademija ima svoju emblemu. |
| **Neni 5**<br>**Subjektiviteti juridik**<br>Akademia është person juridik publik me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë Ligj dhe akte të brendshme të Akademisë, të përcaktuara me Statutin e Akademisë dhe me aktet normative të tjera të veçanta të saj. | **Article 5**<br>**The legal subjectivity**<br>The academy is public legal entity with rights, duties and responsibilities set with this law and internal acts of the Academy, defined with the statute of the Academy and its other special normative acts. | **Član 5**<br>**Pravni subjektivitet**<br>Akademija je javno pravno lice sa pravima, obavezama i odgovornostima u skladu sa zakonom i internim aktima Akademije, definisana Statutom Akademije i drugim specifičnim normativnim aktima. |
| **Neni 6**<br>**Statuti**<br>1. Akademia e ka Statutin e saj. Statuti i Akademisë përcakton, në përputhje me këtë Ligj, organizimin e saj, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe organeve të Akademisë, punës dhe të qeverisjes.<br>2. Statutin e Akademisë e miraton Kuvendi i Akademisë. | **Article 6**<br>**The statute**<br>1. The Academy has its statute. The statute of the Academy defines, in compliance with this law, its organization, manner of electing members and bodies of the Academy, manner of work and of governance.<br>2. The Assembly of the Academy approves the statute of the Academy. | **Član 6**<br>**Statut**<br>1. Akademija ima svoj statut. Statut akademije određuje, u skladu sa ovim zakonom, njegovo organizovanje, način izbora clanova i organa Akademije, rad i upravljanje.<br>2. Statut Akademije se usvaja od strane Skupštine Akademije. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Akademia ka akte të tjera të përgjithshme, me të cilat, në harmoni me Statutin e Akademisë, i rregullojnë çështjet e rëndësishme për punë dhe afarizëm. | 3. The Academy has other general acts, by which in harmony with the statute of the Academy regulate important issues for work and business. | 3. Akademija ima i druge opšte akte, kojima, u skladu sa Statutom Akademije, reguliše važne predmete za rad i poslovanje. |
| **Neni 7**<br>**Financimi** | **Article 7**<br>**The funding** | **Član 7**<br>**Finansiranje** |
| 1. Puna e Akademisë financohet nga:<br><br>1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;<br><br>1.2. Mjetet e fituara nga realizimi i projekteve shkencore dhe artistike;<br><br>1.3. Donacionet dhe burimet e tjera të ligjshme. | 1. The work of the Academy is funded by:<br><br>1.1. The budget of the Republic of Kosova;<br>1.2. The funds earned by implementation of scientific and artistic projects;<br>1.3. Other legitimate donations and resources. | 1. Rad Akademije se finansira od:<br><br>1.1. Budžeta Republike Kosova;<br><br>1.2. Dobijena sredstva iz realizacije naučnih i umetničkih projekta;<br><br>1.3. Donacija i drugih zakonitih izvora. |
| **KAPITULLI II - DISPOZITA TË VEÇANTA** | **CHAPTER II - SPECIAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE II - POSEBNE ODREDBE** |
| **Neni 8**<br>**Qëllimi i Akademisë** | **Article 8**<br>**The purpose of the Academy** | **Član 8**<br>**Svrha Akademije** |
| 1. Qëllimi i Akademisë është zhvillimi, nxitja, promovimi dhe avancimi i shkencës dhe i artit në Kosovë, nëpërmjet:<br><br>1.1. Realizimit të projekteve shkencore me interes për zhvillimin shoqëror, | 1. The purpose of the Academy is development, promotion and advancement of science and arts in Kosova, through:<br><br>1.1. The implementation of scientific projects with interest on social, | 1. Svrha Akademije je da se razvije, promoviše, promocija i unapređenje nauke i umetnosti na Kosovu, kroz:<br><br>1.1. Realizaciju naučnih projekata od interesa za socijalni, ekonomski i |

| | | |
|---|---|---|
| ekonomik dhe kulturor të vendit sipas iniciativës së vet, opinionit të gjerë publik dhe me kërkesën e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës; | economic and cultural development of the country, according to its own initiative, wide public opinion and with request of state institutions of the Republic of Kosova; | kulturni razvoj zemlje na inicijativu šire opšte javnosti i na zahtev državnih institucija Republike Kosova; |
| 1.2. Kujdesit për krijimin dhe avancimin e kuadrove shkencore, sidomos të brezit të ri; | 1.2. The care for creation and advancement of scientific staff, especially of new generation; | 1.2. Staranju za stvaranje i unapređenje naučnih kadrova, posebno mlađe generacije; |
| 1.3. Mbledhjes, sistemimit, ruajtjes dhe studimit të materialeve me interes të veçantë shkencor, sidomos të atyre që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe të kaluarën e Kosovës; | 1.3. Gathering, systematization, preservation and study of materials with special scientific interest, especially of those related to the cultural inheritance and the past of Kosova; | 1.3. Prikupljanja, sistematiziranja, Konzervaciju i proučavanja materijala sa posebnog naučnog interesa, posebno onih koji se odnose na kulturno nasleđe i prošlosti Kosova; |
| 1.4. Pjesëmarrjes në formimin e politikave të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike; | 1.4. Participation in formation of scientific activity policies and of artistic creativity; | 1.4. Učešća u političkom formiranju naučnog i umetničkog stvaralaštva; |
| 1.5 Vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe propozimit të masave për avancimin e mendimit shkencor dhe ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike; | 1.5. Assessment of current situation and proposal of measures for advancement of scientific opinion and quality increase of the artistic creativity; | 1.5. Ocena trenutnog stanja i predlaganje mera za unapređenje naučno mišljenje i poboljšati kvalitet umetničkog stvaralaštva; |
| 1.6. Shqyrtimit të problematikës së përgjithshme nga fushat e veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike; | 1.6. Reviewing general problems from the fields of scientific and artistic creativity; | 1.6. Razmatranja opšte problematike u Oblasti naučnog i umetničkog stvaralaštva; |
| 1.7. Organizimit të punës kërkimore-shkencore me karakter teorik e praktik në fusha të ndryshme të dijes dhe të | 1.7. Organization of scientific research work with theoretical and practical character in different areas of | 1.7. Organizovanja naučno-istraživačkog rada teoretskog i praktičnog karaktera u raznim |

| | | |
|---|---|---|
| arteve përmes tubimeve, tryezave, këshillimeve, simpoziumeve, konferencave shkencore dhe formave përkatëse të shprehjes së krijimtarisë artistike, si ekspozitave, koncerteve, etj. | knowledge and arts, through gatherings, roundtables, consultations, symposiums, scientific conferences and other appropriate forms of artistic expression, such are exhibitions, concerts, etc. | oblastima nauke i umetnosti putem skupova, seminara, savetovanja, simpozijuma, naučne konferencije i drugim odgovarajućim oblicima umetničkog izražavanja, kao što su izložbe, koncerti i sl. |
| 1.8. Botimit të publikimeve të rregullta dhe periodike nga fusha e shkencës dhe e artit, që financohen nga buxheti i Akademisë; | 1.8. Publication of regular and periodical publications from science and art field, which are funded by the budget of the Academy; | 1.8. Objavljivanja redovnih i periodičnih izdanja iz oblasti nauke i umetnosti, koja se finansiraju iz budžeta Akademije; |
| 1.9. Bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Kosovës dhe ato ndërkombëtare nga fusha e shkencës dhe e artit; | 1.9. Cooperation with institutions of the Republic of Kosova and those international from the field of science and art; | 1.9. Saradnja sa institucijama Republike Kosova i međunarodnim iz oblasti nauke i umetnosti; |
| 1.10. Krijimit të kushteve për depërtimin e mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike jashtë kufijve të vendit; | 1.10. Creation of conditions for scientific opinion infiltration and of artistic creativity outside the country's boundaries; | 1.10. Stvaranju uslova za prodiranje naučne misli i umetničkog stvaralaštva van zemlje; |
| 1.11. Përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës të anëtarëve të Akademisë; | 1.11. The continuous improvement of the working conditions of the Academy members; | 1.11. Kontinuiranog poboljšanja uslova rada članova Akademije; |
| 1.12. Zhvillimit të hulumtimeve me interes të veçantë publik e shkencor sipas iniciativës së vet, opinionit të gjerë publik dhe me kërkesën e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës; | 1.12. Development of researches with special public and scientific interest, on its own initiative, the public opinion and at the request of state institutions of the Republic of Kosova; | 1.12. Razvoja istraživanja od posebnog javnog i naučnog interesa na sopstvenu inicijativu, šireg javnog mnjenja i na zahtev državnih institucija Republike Kosova; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.13 Ndërmarrjes së veprimeve të tjera të interesit të veçantë për Kosovën dhe popullatën e saj, e në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Akademisë për të qenë institucion sugjerues dhe këshillues për zhvillimin e shkencës dhe të artit në Kosovë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit. | 1.13. Undertaking other actions of special interest for Kosova and its own population, and in support of the right and obligation of the Academy, to be suggestive and consultative institution for the development of science and art in Kosova, in compliance with development needs of the country | 1.13. Preuzimanja drugih radnji od posebnog interesa za Kosovo i njegov narod, a u prilog prava i obaveza Akademije da bude i savetodavna institucija za razvoj nauke i umetnosti |
| **Neni 9**<br>**Trupat punues dhe bashkëpunimi** | **Article 9**<br>**Working bodies and cooperation** | **Član 9**<br>**Radne trupe i saradnja** |
| 1. Me qëllim të avancimit të punës kërkimore-shkencore dhe artistike me interes të përgjithshëm për shkencën dhe për artin në Kosovë, Akademia themelon seksionet e saj, institutet hulumtuese, njësitë shkencore e artistike dhe qendrat studimore. | 1. In order to advance the scientific-research and artistic work with general interest for science and for art in Kosova, the Academy establishes its sections, research institutions, scientific and artistic units and study centres. | 1. U cilju unapređenja naučno-istraživačkog i umjetničkog rada od opšteg interesa za nauku i umetnost na Kosovu, Akademija uspostavlja osniva njene sekcije, istraživačke institute, naučne i umetničke jedinice i istraživački centri. |
| 2. Akademia në realizimin e funksioneve të saj bashkëpunon me institucionet shkencore dhe akademike të arsimit të lartë, institutet shkencore, entitetet ekonomike dhe biznesore, agjencitë shtetërore si dhe me punëtorët e hulumtuesit shkencorë nga fushat e ndryshme të shkencës dhe të artit. | 2. The Academy in implementation of its functions cooperates with scientific and academic institutions of higher education, scientific institutions, economic and business entities, state agencies and with employees and scientific researchers from different fields of science and art. | 2. Akademija u realizaciji svojih funkcija sarađuje sa akademskim i naučnim institucijama visokog obrazovanja, naučnim institutima, privrednim i poslovnim subjektima, državnim agencijama i naučnim istraživačkim radnicima iz raznih oblasti nauke i umetnosti. |

| Neni 10<br>**Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë** | Article 10<br>**The rights, duties and responsibilities** | Član 10<br>**Prava, obaveze i odgovornosti** |
|---|---|---|
| 1. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Akademisë burojnë nga qëllimet e përgjithshme të saj dhe ato përfshijnë, veçanërisht: | 1. The rights, duties and responsibilities of the Academy derive from its general intentions and those include in particular: | 1. Prava, obaveze i odgovornosti Akademije izviru iz njenih opštih ciljeva i oni uključuju, naročito: |
| 1.1. Planifikimin e punës kërkimore-shkencore dhe artistike në përputhje me mundësitë e saj për realizimin e tyre; | 1.1. Planning of scientific research and artistic work in compliance with its opportunities for their implementation; | 1.1. Planiranje naučno-istraživački i Umjetnički rad u skladu sa svojim mogućnostima za njihovu realizaciju; |
| 1.2. Gatishmërinë për pranimin e anëtarëve të rinj në përputhje me standardet më të larta të veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike; | 1.2. Readiness for admission of new members in compliance with highest standards of scientific activity and of artistic creativity; | 1.2. Spremnost za prihvatanje novih članova u skladu sa najvišim standardima naučnog i umetničkog stvaralaštva; |
| 1.3. Bashkëpunimin e rregullt me institucionet e Republikës së Kosovës, akademitë simotra në rajon, në Evropë e më gjerë, si dhe me organizata shkencore ndërkombëtare me qëllim të komunikimit të ndërsjellë shkencor e artistik dhe për një integrim në rrjedhat botërore të shkencës dhe të artit; | 1.3. Regular cooperation with institutions of the Republic of Kosova, similar academies in the region, in Europe and beyond and with international scientific organizations, for the purpose of scientific and artistic mutual communication and for an integration in global streams of science and of art; | 1.3. Redovna saradnja sa institucijama Republike Kosovo, srodnim akademijama iz regiona, Evrope i šire, kao i međunarodnim naučnim organizacijama u cilju međusobne komunikacije naučnog, umetničkog i integraciju u svetske tokove nauke i umetnosti; |
| 1.4. Realizimin e projekteve me qëllim të ndërtimit të strategjive të zhvillimit të gjithëmbarshëm të vendit dhe të zbatimit praktik të tyre; | 1.4. Implementation of the projects in order to build development strategies of the country and their practical implementation; | 1.4. Realizacija projekata za izgradnju strategija razvoja zemlje i njihove praktične primene; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5. Punën në projekte të përbashkëta me institucionet e ngjashme, me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe të zhvillimit të vlerave kulturore e trashëgimive gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës;<br><br>1.6. Punën në projekte të përbashkëta për studimin dhe zhvillimin e kulturave në Kosovë, dhe<br><br>1.7. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të saktësuara në Statutin e Akademisë dhe në aktet normative të tjera të veçanta të saj.<br><br>**KAPITULLI III - ORGANIZIMI DHE UDHËHEQJA E AKADEMISË**<br><br>**Neni 11**<br>**Organizimi dhe udhëheqja**<br><br>1. Aktiviteti shkencor e artistik në Akademi zhvillohet në kuadër të seksioneve, të instituteve hulumtuese, të njësive shkencore e artistike dhe të qendrave të tjera studimore;<br><br>2. Seksionet janë bartëse të së drejtave, | 1.5. The work in joint institutions with similar institutions, with the aim of preserving, protecting and developing cultural values and linguistic heritage of all citizens of the Republic of Kosova;<br><br>1.6. The work in joint projects for study and development of cultures in Kosova, and<br><br>1.7. The rights, duties and other responsibilities, specified in the Statute of the Academy and in its other special normative acts.<br><br>**CHAPTER III - ORGANIZATION AND LEADERSHIP OF THE ACADEMY**<br><br>**Article 11**<br>**Organization and leadership**<br><br>1. The scientific and artistic activity in the Academy is developed within sections, research institution, of the scientific and artistic units and other study centres;<br><br>2. The sections are holders of rights, duties | 1.5. Rad na zajedničkim projektima sa sličnim institucijama, u cilju očuvanja, zaštite i razvoja kulturnog i jezičkog nasleđa svih građana Republike Kosova;<br><br>1.6. Rad na zajedničkim projektima za istraživanje i razvoj kultura na Kosovu, i<br><br>1.7. Prava, obaveze i druge odgovornosti određene Statutom Akademije i drugim posebnim normativnim aktima.<br><br>**POGLAVLJE III -ORGANIZOVANJE I UPRAVLJANJE AKADEMIJE**<br><br>**Član 11**<br>**Organizovanje i upravljanje**<br><br>1. Naučno i umetnička delatnost Akademije odvija se u okviru sekcija, istraživačkih instituta, naučnih i umetničkih jedinica i drugih studijskih cenuara;<br><br>2. Sekcije su nosioci prava, obaveza i |

| | | |
|---|---|---|
| detyrave dhe përgjegjësive të Akademisë për fushat shkencore e artistike për të cilat janë themeluar; | and responsibilities of the Academy for scientific and artistic fields, for which they are established; | odgovornosti Akademije za naučne i umetničke oblasti za koje su osnovane; |
| 3. Në seksionet e Akademisë veprojnë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të fushave përkatëse shkencore e artistike; | 3. In the Academy sections act regular and part-time members of the relevant scientific and artistic fields; | 3. U sekcijama Akademije deluju redovni i vanredni članovi naučne i umetničke oblasti; |
| 4. Secili anëtar i rregullt dhe korrespondent i Akademisë mund t'i takojë vetëm një seksioni të një fushe apo njësie përkatëse shkencore apo artistike; | 4. Each regular and part-time member of the Academy may be part of only one section of a field or relevant scientific and artistic unit; | 4. Svaki redovni i vanredni član Akademije može biti deo samo jedne sekcije neke oblasti ili dotične naučne i umetničke jedinice; |
| 5. Punën e seksionit e drejton Sekretari i seksionit; | 5. The work of the section is led by the Secretary of the section; | 5. Rad sekcija usmerava ga Sekretar sekcije; |
| 6. Punën e njësive shkencore e artistike, instituteve hulumtuese dhe qendrave të tjera studimore, e drejton drejtori ose organi përkatës drejtues; | 6. The work of scientific and artistic units and other study centres is led by director or the relevant leading body; | 6. Rad naučnih i umetničkih jedinica, istraživačkih instituta i drugih istraživačkih centara, upravlja ga direktor ili odgovarajući upravni organ; |
| 7. Organizimi dhe puna e seksioneve, instituteve hulumtuese dhe njësive, përkatësisht qendrave të tjera studimore të Akademisë, përcaktohet me Statutin e Akademisë dhe me aktet e veçanta normative. | 7. Organization and work of sections, research institutions and units, respectively of other study centres of the Academy, is determined with the Statute of the Academy and with special normative acts. | 7. Organizacija i rad sekcija, istraživačkim institutima i jedinicama, odnosno drugim istraživačkim centrima Akademije, utvrđuje se Statutom Akademije i posebnim normativnim aktima. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 12**<br>**Organet e Akademisë**<br><br>1. Organet e Akademisë janë:<br><br>1.1. Kuvendi;<br><br>1.2. Kryesia, dhe<br><br>1.3. Kryetari. | **Article 12**<br>**The bodies of the Academy**<br><br>1. The bodies of the Academy are:<br><br>1.1. Assembly;<br><br>1.2. Chairmanship, and<br><br>1.3. Chairman | **Član 12**<br>**Organi Akademije**<br><br>1. Organi Akademije su:<br><br>1.1. Skupština;<br><br>1.2. Predsedništvo, i<br><br>1.3. Predsednik. |
| **Neni 13**<br>**Kuvendi i Akademisë**<br><br>1. Kuvendi i Akademisë është organi më i lartë i qeverisjes së saj;<br><br>2. Kuvendin e Akademisë e përbëjnë të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të saj;<br><br>3. Në punën e Kuvendit të Akademisë mund të marrin pjesë edhe anëtarët e jashtëm të saj, pa të drejtë vote;<br><br>4. Seancën e Kuvendit të Akademisë e thërret Kryesia e Akademisë, vetë ose me propozimin e më së paku dy seksioneve të Akademisë a të 10 anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë. | **Article 13**<br>**Assembly of the Academy**<br><br>1. Assembly of the Academy is highest body of its governance;<br><br>2. Assembly of the Academy consists by all its regular and part-time members;<br><br>3. In the work of Assembly of the Academy can participate also its external members, without voting rights;<br><br>4. The Academy's leadership convenes the session of Assembly of the Academy, alone or with the proposal of at least two sections of the Academy of the 10 regular and part-time members of the Academy. | **Član 13**<br>**Skupština Akademije**<br><br>1. Skupština Akademije je najviši organ upravljanja;<br><br>2. Skupštinu Akadermije sačine svi njeni redovni i vanredni članovi;<br><br>3. U rad Skupštine Akademije učestvuju i njeni spoljni članovi, bez pravu glasa;<br><br>4. Sednicu Skupštine Akademija saziva je Predsedništvo akademije, sam ili na predlog najmanje dve sekcije Akademije ili 10 redovnih ili vanredn članova. |

| Neni 14<br>Detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Akademisë | Article 14<br>Duties and responsibilities of the Assembly of the Academy | Član 14<br>Obaveze i odgovornosti Skupštine Akademije |
|---|---|---|
| 1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Akademisë përfshijnë: | 1. Duties and responsibilities of the Assembly of the Academy include: | 1. Obaveze i odgovornosti Skupštine akademije obuhvataju: |
| 1.1. Miratimin e Statutit të Akademisë; | 1.1. Approval of the Statute of the Academy; | 1.1. Usvajanje Statuta Akademije; |
| 1.2. Miratimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe akteve të tjera normative që rregullojnë marrëdhënie të caktuara nga veprimtaria e Akademisë; | 1.2. Approval of instructions, regulations and other normative acts by adjusting certain agreements from the activity of the Academy; | 1.2. Usvajanje uredba, pravilnika i drugih normativnih akata koja regulišu određene odnose delatnosti Akademije; |
| 1.3. Themelimin e instituteve hulumtuese, njësive shkencore e artistike dhe qendrave studimore; | 1.3. Establishment of research institutions, scientific and artistic units and study centres; | 1.3. Osnivanje istraživačkih instituta, naučnih i umetničkih jedinica i studijski centri; |
| 1.4. Miratimin e programit të punës së Akademisë; | 1.4. Approval of the Academy's work program; | 1.4. Usvajanje radnih programa Akademije; |
| 1.5. Propozimin e buxhetit vjetor të Akademisë; | 1.5. Proposal of the Academy's annual budget; | 1.5. Predlog godišnjeg budžeta Akademije; |
| 1.6. Miratimin e raportit të punës së Akademisë; | 1.6. Aproval of the report of the work of the Academy; | 1.6. Usvajanje izvestaja o radu Akademije; |
| 1.7. Miratimin e planit financiar dhe të llogarive përfundimtare të Akademisë; | 1.7. Approval of financial plan and of the Academy's final accounts; | 1.7. Usvajanje finansijskog plana i završnih računa Akademije; |
| 1.8. Zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë; | 1.8. Election of regular and part-time members of the Academy; | 1.8. Biranje redovnih i vanrednih članova Akademije; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.9. Zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit, nënkryetarit dhe sekretarit shkencor të Akademisë; | 1.9. Election and discharge of chairman, deputy chairman and scientific secretary of the Academy; | 1.9. Biranje i razrešenje predsednika, potpredsednika i naučnog sekretara Akademije; |
| 1.10. Verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë, dhe<br>1.11. Detyrat e tjera që përcaktohen me këtë Ligj dhe me Statutin e Akademisë. | 1.10. The selection verification of secretaries of the Academy sections, and<br>1.11. Other duties defined by this law and with the Statute of the Academy. | 1.10. Verifikaciju izbora sekretara sekcije Akademije, i<br>1.11. Druge obaveze koja se određujuv ovom zakonom i Statutom Akademije. |
| **Neni 15**<br>**Marrja e vendimeve** | **Article 15**<br>**The decision making** | **Član 15**<br>**Donošenje odluka** |
| 1. Kuvendi i Akademisë mund të mblidhet dhe të vendosë nëse në të është e pranishme shumica e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë. | 1. The Assembly of the Academy can be gathered and decide whether the presence of the majority of regular and part-time members of the Academy is in it. | 1. Skupština Akademije može da zaseda i odlučuje ako je prisutna većina članova redovnih i dopisnih članova Akademije. |
| 2. Për miratimin e Statutit të Akademisë, për zgjedhjen e Kryetarit, të Nënkryetarit dhe të Sekretarit shkencor të Akademisë, për verifikimin e zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë dhe të anëtarëve të jashtëm të Akademisë, është e nevojshme shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë. | 2. For approval of the Academy Statute, for Chairman election, of Deputy chairman, and of the Academy's scientific Secretary, for selection verification of secretaries of the Academy sections, and for elections of part-time members and external members of the Academy, is necessary the majority of regular and part-time votes of the Academy. | 2. O odobravanju Statuta Akademije, o izboru Predsednika, Potpredsednika i naučnog Sekretara Akademije, da proveri izbor sekretara sekcija Akademije, kao i da izbor dopisnih i vanjskih članova Akademije, je potrebna večina glasova svih redovnih i vanrednih članova Akademije. |
| 3. Për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt është e nevojshme shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt të Akademisë. | 3. For election of regular members is needed majority of votes of all regular members of the Academy. | 3. Za redovni izbor članova je potrebna je većina glasova svih redovnih članova Akademije. |

| Neni 16<br>**Kryesia e Akademisë** | Article 16<br>**The Academy's chairmanship** | Član 16<br>**Predsedništvo Akademije** |
|---|---|---|
| 1. Kryesinë e Akademisë e përbëjnë: Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë. | 1. The Academy's chairmanship comprise of: Chairman, Deputy chairman, scientific Secretary and secretaries of the Academy sections. | 1. Predsedništvo Akademije čine: Predsednik, Potpredsednik, naučni Sekretar i sekretari sekcija Akademije. |
| 2. Kryesia e Akademisë koordinon punën e përgjithshme nga fusha e përgjegjësive të saj. | 2. The Academy's chairmanship coordinates general works from the area of its responsibilities. | 2. Predsedništvo Akademije koordinira ukupan rad od svojih odgovornosti. |
| 3. Kryesia e Akademisë për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë. | 3. The Academy's chairmanship for its work responds to the Assembly of the Academy. | 3. Predsedništvo Akademije za svoj rad odgovara pred Skupštine Akademije. |
| 4. Kryesia zbaton vendimet e Kuvendit të Akademisë dhe qëndrimet e tij. | 4. The chairmanship implements decisions of the Assembly of the Academy and its positions. | 4. Predsedništvo sprovodi odluke Skupštine Akademije i njenih stavova. |
| 5. Anëtarët e Akademisë mbi moshën 75 vjeçare nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse. | 5. The Academy members over 75 years of age cannot exercise leading functions. | 5. Članovi Akademije starijih od 75 godina ne mogu obavljati rukovodeče funkcije. |
| 6. Anëtarët e Akademisë që ushtrojnë funksione politike dhe shtetërore, nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse në Akademi. | 6. The Academy members exercising political and state functions cannot exercise leading functions at the Academy. | 6. Članovi Akademije, koji vrše političke i državne funkcije, ne mogu obavljati rukovodeće funkcije u Akademiji. |
| 7. Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katërvjeçare me të drejtë edhe të një rizgjedhjeje. | 7. The Academy's chairmanship is elected for a four-year period with the right of being re-elected once more. | 7. Predsedništvo Akademije bira se na period od četiri godine i imaju pravo na još jedan reizbor. |

| Neni 17<br>**Kryetari i Akademisë** | Article 17<br>**The Academy's chairman** | Član 17<br>**Predsednik Akademije** |
|---|---|---|
| 1. Kryetari i Akademisë: | 1. The Academy's chairman: | 1. Predsednik Akademije: |
| 1.1 Udhëheq punën e Akademisë; | 1.1. Leads the Academy's work; | 1.1. Rukovodi rad Akademije; |
| 1.2 Përfaqëson dhe e prezanton Akademinë; | 1.2. Represents and presents the Academy; | 1.2. Zastupa i predstavlja Akademiju; |
| 1.3 Udhëheq punën e Kryesisë dhe të Kuvendit të Akademisë; | 1.3. Leads the work of the Chairmanship and of the Assembly of Academy; | 1.3. Rukovodi rad Predsedništva i Skupštine Akademije; |
| 1.4 Zgjedhet nga Kuvendi i Akademisë për një periudhë katërvjeçare me të drejtë edhe të një rizgjedhjeje; | 1.4. Is elected by the Assembly of the Academy for a four-year period with the right of being re-elected once more; | 1.4. Bira se od Skupštine Akademije na četvorogodišnji period sa pravom za još jedan reizbor; |
| 1.5 Nënshkruan të gjitha vendimet e Kryesisë dhe Kuvendit të saj; | 1.5. Signs all decisions of the Chairmanship and its Assembly; | 1.5. Potpisuje sve odluke Predsedništva i njene skupštine; |
| 1.6 Përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Akademisë; | 1.6. Responds on the legitimacy of the Academy's work; | 1.6. Odgovara o zakonitosti rada Akademije; |
| 1.7 Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë, ndërsa në kuadër të së drejtave dhe detyrave të Kryesisë së Akademisë, i përgjigjet Kryesisë. | 1.7. For its work responds to the Assembly of the Academy, while within the rights and duties of the Assembly of the Academy, responds to the Chairmanship. | 1.7. Za svoj rad odgovara Skupštini Akademije, dok u okviru prava i obaveza redsedništva Akademije, odgovara Predsedništvu. |

| | | |
|---|---|---|
| **KAPITULLI IV - ANËTARËT E AKADEMISË**<br><br>**Neni 18**<br>**Anëtarët**<br><br>1. Akademia ka anëtarë të rregullt, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi.<br><br>2. Të qenët anëtar i Akademisë është i përjetshëm.<br><br>**Neni 19**<br>**Anëtarë të rregullt**<br><br>1. Anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen punonjësit e shkencës ose të artit për të arritura të veçanta në fushat e shkencës dhe të artit.<br><br>2. Vetëm anëtarët e rregullt të Akademisë kanë të drejtë ta bartin titullin "Akademik".<br><br>3. Anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen shtetasit e Kosovës që janë punonjës të shquar të shkencës dhe të artit që kanë arritje shkencore dhe artistike, veprat e të cilëve paraqesin realizime kulmore në fushat e shkencës ose të artit dhe janë me peshë në vend dhe jashtë tij. | **CHAPTER IV - THE ACADEMY MEMBERS**<br><br>**Article 18**<br>**Members**<br><br>1. The Academy has regular members, part-time members, external members and honorary members.<br><br>2. Being member of the Academy is eternal.<br><br>**Article 19**<br>**The regular members**<br><br>1. The regular members of the Academy can be elected scientific or art employees, for special achievements in the fields of science and art.<br><br>2. Only the regular members of the Academy have the right to carry the title "Academic".<br><br>3. The regular members of the Academy can be citizens of Kosova that are distinguished science employees and of art, that have scientific and artistic achievements, whose works represent culminant realizations in the science or art field and are very valuable inside and | **POGLAVLJE IV - ČLANOVI AKADEMIJE**<br><br>**Član 18**<br>**Članovi**<br><br>1. Akademija ima redovne, vanredne, spoljne i počasne članove.<br><br>2. Mandat člana Akademije je doživotni.<br><br>**Član 19**<br>**Redovni članovi**<br><br>1. Redovni članovi Akademije mogu biti birani naučni i umetnički radnici za posebna dostignuća u oblasti nauke i umetnosti.<br><br>2. Samo redovni članovi Akademije imaju pravo da nose titulu „Akademik".<br><br>3. Redovni članovi Akademije mogu biti birani kosovski građani koji su istaknuti naučni i umetnički radnici koji imaju naučne i umetničke rezultate, čiji radovi predstavljaju kulminaciju dostignuća u oblasti nauke i umetnosti i predstavljaju vrednost u zemlji i inostranstvu. |

| | | |
|---|---|---|
| | outside the country. | |
| **Neni 20**<br>**Anëtarë korrespondentë**<br><br>Anëtarë korrespondentë të Akademisë mund të zgjidhen punonjës të shkencës ose të artit, shtetas të Kosovës, të cilët kanë krijuar vepra shkencore dhe artistike të një rëndësie të veçantë. | **Article 20**<br>**Part-time members**<br><br>Part-time members of the Academy can be elected employees of science or art, citizens of Kosova, who have created scientific and artistic works of special significance. | **Član 20**<br>**Vanredni članovi**<br><br>Vanredni članovi Akademije mogu se birati naučni i umetnički radnici državljani Kosova, koji su kreirali naučnih i umetničkih dela od posebnog značaja. |
| **Neni 21**<br>**Anëtarë të jashtëm**<br><br>1. Anëtarë të jashtëm të Akademisë mund të zgjidhen punonjësit e shkencës ose të artit që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit, por të cilët kanë krijuar vepra të rëndësishme me vlerë për Kosovën, ose me vlerë të përgjithshme për shkencën dhe artin.<br><br>2. Anëtarëve të jashtëm të Akademisë u pranohet statusi i anëtarëve të rregullt a korrespondentë në pajtim me dispozitat e statutit të Akademisë. | **Article 21**<br>**External members**<br><br>1. External members of the Academy can be elected employees of science or art living and acting outside the country, but who have created significant work with value for Kosova, or with general value for science and art.<br><br>2. The statute of regular and part-time members is accepted for external members of the Academy in accordance with the provisions of the Statute of the Academy. | **Član 21**<br>**Spoljni članovi**<br><br>1. Spoljni članovi Akademije mogu da se biraju naučni i umetnički radnici koji žive i rade u inostranstvu, ali koji su postigli značajna dela za Kosovu, ili ukupne naučne vrednosti i umetnosti.<br><br>2. Spoljnim članovima Akademije je prihvaćen statute redovnih članova ili dopisnika u skladu sa odredbama Statuta Akademije. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 22**<br>**Anëtarë nderi**<br><br>Anëtarë nderi të Akademisë mund të zgjidhen krijues të shquar të shkencës dhe të artit, që nuk janë shtetas të Kosovës, por të cilët me realizimet e veta janë bërë përgjithësisht të njohur për shkencën ose artin, dhe të cilët kanë dhënë kontribut për Kosovën. | **Article 22**<br>**Honorary members**<br><br>Honorary members of the Academy can be elected distinguished creators of science and of art, which are not citizens of Kosova, but with their achievements have become generally known to science or art, who have contributed to Kosova. | **Član 22**<br>**Počasni članovi**<br><br>Počasni članovi Akademije mogu biti birani eminentni naučni i umetnički stvaraoci, koji nisu državljani Kosova, ali koji su svojim ostvarenjima postali opšte priznati za nauku ili umetnost koji su dali doprinos za Kosovo. |
| **Neni 23**<br>**Procedura e zgjedhjes**<br><br>Procedura e propozimit, e votimit dhe e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë përcaktohet me Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë. | **Article 23**<br>**The election procedure**<br><br>The procedure of proposal, of voting and of election of the Academy members is defined with statute and other normative acts of the Academy. | **Član 23**<br>**Procedura izbora**<br><br>Procedura predloga, glasanja i izbor članova Akademije utvrdi se Statutom i drugim normativnim aktima Akademije. |
| **Neni 24**<br>**Mandati**<br><br>1. Zgjedhjet për anëtarë të Akademisë bëhen për çdo katër vjet.<br><br>2. Anëtarë të Akademisë mund të zgjidhen kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën mbi 65 vjeç. | **Article 24**<br>**Mandate**<br><br>1. The elections for members of the Academy are done every four years.<br><br>2. The Academy members can be elected candidates, who have not passed the age of 65. | **Član 24**<br>**Mandat**<br><br>1. Mandat članova Akademije je četiri godina.<br><br>2. Za članove Akademije mogu se birati kandidati koji nisu stigli doba više od 65 godina. |

| Neni 25<br>**Të drejtat dhe detyrat** | Article 25<br>**The rights and duties** | Član 25<br>**Prava i obaveza** |
|---|---|---|
| Me zgjedhjen si anëtarë të rregullt dhe korrespondentë, anëtarët e Akademisë gëzojnë të drejta dhe marrin detyra dhe përgjegjësi, të përcaktuara me këtë Ligj dhe me Statutin e Akademisë. | With election as regular and part-time members, the Academy members enjoy the rights and take duties and responsibilities, defined with this law and with the Academy statute. | Izborom kao redovnih članova i dopisnika, članovi Akademije uživaju prava, dužnosti i odgovornosti utvrđenih ovim zakonom i Statutom Akademije. |
| **Neni 26**<br>**Shpërblimet** | **Article 26**<br>**Rewards** | **Član 26**<br>**Nagrade** |
| 1. Anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë me qëndrim të përhershëm në vend, ju takon shpërblimi i përhershëm mujor. | 1. The regular and part-time members of the Academy with permanent residence in the country are entitled to permanent monthly reward. | 1. Redovni i vanredni članovi Akademije stalnom boravkom kao stanovnici zemlje, imaju pravo na stalna mesečna nadoknada. |
| 2. Lartësia e shpërblimeve për anëtarë të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë bazohet në vendimin nr. 02/211 të 16 gushtit 2006 të Qeverisë së Kosovës dhe do të ndryshojë në varësi prej vendimeve për lartësinë e pagave të profesorëve të rregullt dhe të asociuar universitar. | 2. The height of rewards for regular and part-time members of the Academy is based on decision no. 02/211 of August 16, 2006 of the Government of Kosova and will change depending on decisions for salary height of regular and associate university professors. | 2. Visina naknade za redovnih i dopisnih članove Akademije na osnovu odluke br . 02/211 od 16. avgusta 2006. godine Vlade Kosova i će promeniti u zavisnosti od odluke o visini zarada redovnih profesora i saradnika univerziteta. |
| 3. Anëtarëve të kryesisë, përkatësisht: Kryetarit, Nënkryetarit, Sekretarit shkencor dhe sekretarëve të seksioneve, ju takon shtesa funksionale mujore për funksionet që i kryejnë. | 3. The chairmanship members, respectively: Chairman, Deputy chairman, scientific Secretary and secretaries of sections, are entitled to functional monthly allowances for the functions performed. | 3. Članovi predsedništva, odnosno Predsednika, Potpredsednika, naučnog Sekretara i sekretari sekcija, pripada im mesečni funkcionalni dodatak za njihova funkcija. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Kriteret dhe lartësia e shtesave funksionale mujore të anëtarëve të Akademisë për funksionet që i kryejnë në Akademi, caktohen me vendim të posaçëm të Kryesisë së Akademisë. | 4. The criteria and height of members' functional monthly allowance of the Academy for the functions performed at the Academy are set with special decision of the Academy Chairmanship. | 4. Kriterijumi i iznos mesečne fukcionalne naknade članova Akademije za njihove funkcije kojima se bavljaju u Akademiji određuju se posebnom odlukom Akademije. |
| **KAPITULLI V - SHËRBIMET PROFESIONALE ADMINISTRATIVE E TEKNIKE** | **CHAPTER V - ADMINISTRATIVE, PROFESSIONAL AND TECHNICAL SERVICES** | **POGLAVLJE V-ADMINISTRATIVNE, PROFESIONALNE I TEHNIČKE USLUGE** |
| **Neni 27**<br>**Shërbimet e Akademisë** | **Article 27**<br>**The services of the Academy** | **Član 27**<br>**Usluge Akademije** |
| 1. Shërbimet profesionale administrative, e teknike i kryen Sekretariati i Akademisë. | 1. Administrative, professional and technical services are performed by the Academy administration. | 1. Administracija Akademije vrši administrativne, profesionalne i tehničke usluge. |
| 2. Sekretariatin e Akademisë e udhëheq Sekretari i Akademisë. | 2. Secretary of the Academy leads the Academy administration. | 2. Administraciju Akademije rukovodi je sekretar Akademije. |
| 3. Sekretari i Akademisë zgjidhet nga Kryesia e Akademisë me konkurs publik. | 3. Secretary of the Academy is elected by the Academy Chairmanship with public competition. | 3. Sekretar Akademije se bira od Predsedništva Akademije na javni konkurs. |
| 4. Për punën e vet Sekretari i Akademisë i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë. | 4. For its work, the Secretary of the Academy responds to Chairman and Chairmanship of the Academy. | 4. Za svoj rad sekretar Akademije se odgovara pred Predsdnika i Predsedništva Akademije. |
| 5. Të punësuarit në shërbimet profesionale, administrative, e teknike kanë statusin e | 5. The employees in administrative, professional and technical services have | 5. Zaposleni u administrativnim, profesionalnim i tehničkim uslugama |

| | | |
|---|---|---|
| nëpunësit civil, që rregullohet me Ligj dhe me Statutin e Akademisë. | the statute of civil service, which is adjusted with law and with the Statute of the Academy. | imaju statute civilnog službenika koja se reguliše Zakonom i Statutom ove Akademije. |
| **KAPITULLI VI - MJETET E AKADEMISË** | **CHAPTER VI - THE MEANS OF THE ACADEMY** | **POGLAVLJE VI - SREDSTVA AKADEMIJE** |
| **Neni 28**<br>**Financimi** | **Article 28**<br>**Funding** | **Član 28**<br>**Finansija** |
| 1. Mjetet themelore dhe financiare për punën e Akademisë sigurohen nga buxheti i Kosovës, në zë të veçantë. | 1. Basic and financial means for the work of the Academy are provided by the Kosova budget, on a specific way. | 1. Osnovna i finansijska sredstva performanse Akademije obezbedjuju se iz budžeta Kosova, u posebnom glasu. |
| 2. Me mjetet nga buxheti i Kosovës mbështetet puna e seksioneve, instituteve hulumtuese, njësive dhe qendrave të tjera studimore të Akademisë, puna e organeve të qeverisjes së Akademisë, bashkëpunimi ndërkombëtar i Akademisë, veprimtaria e rregullt botuese dhe periodike e Akademisë, pasurimi i fondit të bibliotekës së Akademisë, shpërblimet e përhershme mujore të anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë të Akademisë, shtesat funksionale për kryerjen e funksioneve të caktuara në Akademi, pagat e përhershme mujore për të punësuarit në shërbimet profesionale, administrative, e teknike dhe të mirëmbajtjes së Akademisë. | 2. With means from the Kosova budget, work of sections, research institutions, units and other study centres of the Academy is supported, international cooperation of the Academy, regular and periodical publishing activity of the Academy, enrichment of the library of the Academy, permanent monthly remuneration of the regular and part time members, functional allowances for performance of certain functions at the Academy, permanent monthly salaries for employees in administrative, professional, technical services and maintenance of the Academy. | 2. Sa sredstvima iz budžeta Kosova podržavaju rad sekcija, istraživačkih instituta, jedinica i drugih istraživačkih centara Akademije, rad državnih organa Akademije, međunarodna saradnja Akademije, redovno i periodično izdavačke radnje Akademije, obogaćenje biblioteke Akademije, stalne mesečne naknade redovnih i dopisnih članova Akademije, funksionalne dopune za obavljanje određenih funkcija u Akademiji, stalne mesečne plate zaposlenima u stručnim i tehničkim službama i održavanje Akademije. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Akademia mund të sigurojë mjete edhe nga donacionet dhe sponsorizimet dhe ato mjete mund t’i përdorë për veprimtarinë plotësuese të saj. | 3. The Academy can provide means also from donations and sponsorships and those means can use for its supplementary activity. | 3. Akademija može da obezbedi sredstva iz donacija i sponzora i ta sredstva mogu koristiti za svoju dopunsku delatnost. |
| 4. Akademia mund të sigurojë mjete të tjera plotësuese për punën kërkimore-shkencore e artistike të anëtarëve të saj të rregullt dhe korrespondentë përmes aktiviteteve të veta, marrëveshjeve të ndërsjella kërkimore-shkencore e artistike dhe përmes donacioneve e dhuratave ose mbi ndonjë bazë tjetër juridikisht të lejueshme. | 4. The Academy can provide other supplementary means for scientific research and artistic work of its regular and part time members through its activities, scientific research and artistic mutual agreements and through donations of gifts or upon any other legal permissible basis. | 4. Akademija može da obezbedi druga dodatna sredstva za naučni i umetnički rad svojih redovnih i vanrednih članova kroz svoje aktivnosti, međusobnim sporazumima naučnog i umetničkog i preko donacija i poklona ili na nekoj drugoj zakonsko dozvoljenoj osnovi. |
| **Neni 29**<br>**Pronësia e Akademisë** | **Article 29**<br>**The ownership of the Academy** | **Član 29**<br>**Vlasništvo Akademije** |
| 1. Akademia është pronare e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme me të cilën disponon dhe që i është dhënë për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është themeluar. | 1. The Academy is owner of the movable and real estate, at its disposal and which is given to it for activity performance for which is established. | 1. Akademija je vlasnik pokretne i nepokretne imovine sa kojima raspolaže i koja mu je data za obavljanje delatnosti za koju je osnovana. |
| 2. Akademia si titullar është entiteti i vetëm juridik që mund të marrë vendim për bartjen e të drejtave të saj pronësore. | 2. The Academy as a holder is the only legal entity that can take decision for transfer of its ownership rights. | 2. Akademija kao zvaničnik je jedini entitet koji može da donese odluku da prebaci svoja imovinska prava. |

| | | |
|---|---|---|
| **KAPITULLI VII - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE** | **CHAPTER VII - TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE VII - PREL AZNE I ZAVRŠNE ODREDBE** |
| **Neni 30**<br>**Dispozitat kalimtare** | **Article 30**<br>**Transitional provisions** | **Član 30**<br>**Prelazne odredbe** |
| 1. Dispozitat e nenit 9 paragrafit 1, nenit 14 paragrafi 1 nënparagrafit 1.3 dhe nenit 24 të këtij ligji mund të hyjë në fuqi nga viti buxhetor 2016, po qe se krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi ekzakt të kostos financiare të periudhës vijuese. | 1. Provisions of article 9, paragraph 1, article 14, paragraph 1, sub-paragraph 1.3 and article 24 of this law can enter into force from the budgetary year 2016, if financial conditions are created and after an exact evaluation of the financial cost for the following period. | 1. Odredbe iz član 9 stav 1, člna 14 stav 1 pod-stav 1.3. i člna 24 ovoga zakona mogu stupiti na snagu od budžetske godine 2016-te, u koliko budu stvoreni finansijski uslovi i nakon precize procene finansijskog iznosa narednog perioda. |
| 2. Akademia duhet të harmonizojë organizimin dhe punën e saj, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë, me dispozitat e këtij Ligji brenda gjashtë muajve nga hyrja e tij në fuqi. | 2. The Academy should harmonize organization and its work, statute and other normative acts of the Academy, with provisions of this law within six months from its entry into force. | 2. Akademija treba da uskladjuje svoju organizaciju i rad sa Statutom i drugim normativnim aktima Akademije sa odredbama ovog zakona u roku od šest meseci od dana stupanja na snagu . |
| **Neni 31**<br>**Kryerja e funksioneve** | **Article 31**<br>**Performance of functions** | **Član 31**<br>**Obavljanje funkcija** |
| Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë, i kryejnë funksionet e veta deri me kalimin e kohës mandatore për të cilën janë zgjedhur. | Chairman, Deputy Chairman, scientific secretaries and secretaries of the Academy sections, perform their functions for which are selected up to the completion of the mandatory time. | Predsednik, Potpredsednik, naučni Sekretar i sekretari sekcija obavljaju svoje funkcije do izvršenja obaveznog vremena za koje su izabrani. |

| Neni 32<br>Dispozitat shfuqizuese | Article 32<br>Repealing provisions | Član 32<br>Vansnažne odredbe |
|---|---|---|
| Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji nr. 2004 / 19 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 25 / 01 qershor 2008). | With entry into force of this law, is repealed the Law no. 2004/ 19 on Academy of Science and Arts of Kosovo (Official Gazette of the Republic of Kosova, No. 25 / 01 june 2008). | Stupanjem na snagu ovog zakona, stavlja se van snage Zakon br. 2004/ 19 o Akademiji Nauka i Umetnosti Kosova (Službeni List Republike Kosova, Br. 25 / 01 juni 2008). |
| **Neni 33**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 33**<br>**Entry into force** | **Član 33**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. | This law enters into force (15) fifteen days after publication in the official gazette of the Republic of Kosova. | Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u službenom glasniku Republike Kosova. |
| **Kadri Veseli**<br>____________________<br>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës | **Kadri Veseli**<br>____________________<br>The President of the Assembly of the Republic of Kosovo | **Kadri Veseli**<br>____________________<br>Predsednik Skupštine Republike Kosovo |